

Në bazë të nenit 36 paragrafi 1 pika 2 e Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e R.M." nr. 5/2002) dhe nenit 28 paragrafi 1 i Ligjit për financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 61/2004, 96/2004 dhe 67/2007), Këshilli i Qytetit të Shkupit në seancën e pesëdhjetetë, mbajtur më 27 dhjetor 2007, solli

BUXHET **të Qytetit të Shkupit për vitin 2008**

1. Pjesa e përgjithshme

Neni 1

Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2008 përbëhet prej:

Të hyra të përgjithshme **3.040.567.500,00 denarë**
edhe atë:

-të hyra tatimore	1.575.800.000,00 denarë;
-të hyra jotatimore	481.073.963,00 denarë;
-të hyra kapitale	120.950.000,00 denarë;
-dotacione të destinuara	211.825.077,00 denarë;
-transfere	263.070.000,00 denarë;
-donacione	147.148.460,00 denarë;
-shitje e letrave me vlerë	240.000.000,00 denarë

Shpenzime të përgjithshme **3.040.567.500,00 denarë**
denarë
edhe atë:

- qëllime të përcaktuara	3.025.567.500,00 denarë;
- rezerva	15.000.000,00 denarë

Neni 2

Të hyrat e Buxhetit sipas llojit të të hyrave janë përcaktuar në bilancin e të hyrave, kurse shpenzimet sipas qëllimeve themelore janë përcaktuar në bilancin e shpenzimeve edhe atë si vijon: